

Vendim nr. 188, datë 04.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 04.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (K) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: KLEVIS ARBRI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1864, datë 22.06.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 00-2025-619 (92), datë 10.04.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 e vijues, 71, 71/a, 72 dhe 73 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është akuzuar dhe dërguar për gjykim për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283, paragrafi i

dytë, i Kodit Penal (KP). Gjykimi i kësaj çështjeje është zhvilluar me procedurën e gjykimit të shkurtuar, në gjendjen e akteve të fashikullit të hetimeve, në përputhje me nenet 403 – 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1864, datë 22.06.2021, ndër të tjera, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim, dhe bazuar në nenin 283, paragrafi i dytë, të KP-së, dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të KPP-së, kërkuesit i ulet 1/3-ta e dënimit dhe dënohet përfundimisht me 5 (pesë) vjet burgim”. Sipas asaj gjykate, bazuar në aktet e fashikullit hetimor, rezulton e provuar se kërkuesi ka bashkëpunuar me të pandehurin J.Ç. në blerjen e lëndës narkotike të llojit “heroinë” dhe shitjen e saj personit të autorizuar, dhe kjo del e qartë nga procesverbali i transkriptimit të bisedës të datës 01.09.2020 që ai zhvillon me personin e infiltruar, ku kërkuesi pohon se lënda narkotike për të cilën po diskutohet nuk ka asnjë gram përzierje, pasi është vetë ai personi që e ka sjellë këtë lëndë, duke i dhënë kështu garanci personit të infiltruar për pastërtinë e lëndës narkotike dhe duke i treguar atij se ka një kohë të gjatë që merret me shitjen e saj. Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se procesverbali i transkriptimit të bisedës përputhet plotësisht me procesverbalin e sekuestrimit të provës materiale të lëndës narkotike të blerë dhe për këtë arsye krijohet bindja e arsyeshme se të pandehurit (përfshirë kërkuesin) kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar. Ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka bërë ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 247, datë 15.03.2022, ndër të tjera, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 1864, datë 22.06.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i KP-së dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të KPP-së, dënimin përfundimtar të kërkuesit me 2 vjet burgim”. Në lidhje me kërkuesin, gjykata e apelit ka vlerësuar se nga provat e administruara në dosje nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm që ai të ketë kryer veprën penale të parashikuar neni 283, paragrafi i dytë, i KP-së dhe nuk provohet se ka konsumuar nga ana objektive figurën e asaj veprë penale. Sipas gjykatës së apelit, nga përgjimet e bisedave telefonike arrihet të identifikohet qartë fakti se kërkuesi ka qenë në dijeni të veprimtarisë kriminale që ushtronte i pandehuri J.Ç. dhe e vetmja indicie që rezulton nga dosja e prokurorit, për sa i përket implikimit të kërkuesit në aktivitetin kriminal objekt akuze, buron nga thëniet e vet atij gjatë përgjimit ambiantal, të transkriptuar. Po ashtu, gjykata e apelit ka vlerësuar se e vetme dhe e palidhur me asnjë provë ose indicie tjetër, kjo rrethanë e bën të pamjaftueshme bazueshmërinë e akuzës për të provuar fajësinë e kërkuesit për sa akuzohet dhe kjo rrethanë provon faktin se ai (kërkuesi) kishte dijeni për

aktivitetin kriminal të të pandehurit J.Ç. dhe megjithëse kishte detyrim ligjor për ta kallëzuar atë, nuk e ka bërë një gjë të tillë. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-619 (92), datë 10.04.2025, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 247 datë 15.03.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1864, datë 22.06.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vlerësimin e Kolegjit Penal pretendimet e organit të akuzës se vendimmarrja e gjykatës së apelit është e gabuar në lidhje me rrethanën cilësuese të bashkëpunimit dhe ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal të atribuar kërkuesit, duke ngritur si shkak pamjaftueshmërinë e arsytimit, janë të bazuara, pasi gjykata e apelit në arritjen e këtij konkluzioni nuk ka vlerësuar e çmuar provat e marra e të verifikuara në këtë gjykim në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 152 të KPP-së. Sipas atij kolegji, gjykata e apelit ka pasur detyrimin ligjor që në procesin e vlerësimit dhe çmuarjes së provave t'i analizojë këto prova në unitet me njëra – tjetrën, duke argumentuar vendimmarrjen dhe duke dhënë arsyt ku bazohet konkluzioni i arritur, si dhe përse provat e paraqitura nga prokuroria në mbështetje të akuzës nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë. Po ashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se gjykata e apelit nuk ka pasqyruar qartë dhe saktë cili është mekanizmi i kryerjes së veprës penale dhe rolin e secilit prej të gjykuarve në raport me veprën penale. Sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit nuk ka dhënë arsye të përligjura në raport me vendimin e marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka mbështetur akuzën e atribuar nga prokuroria të gjykuarve, duke analizuar veprimet dhe mosveprimet e të gjykuarve në lidhje me faktin penal. Po sipas Kolegjit Penal, bashkëpunimi mes të gjykuarve është verifikuar nga përmbajtja e bisedave të përgjuara, të transkriptuara në aktet/procesverbalet e datës 01.09.2020, ku citohen bisedat e kërkuesit me personin e autorizuar për kryerjen e veprimeve simuluese dhe nga përmbajtja e këtyre akteve është verifikuar se kërkuesi ka pohuar që lënda narkotike për të cilën po diskutohet nuk ka asnjë gram përzierje, pasi është vetë ai personi që e ka sjellë këtë lëndë, duke i dhënë garanci për pastërtinë e lëndës narkotike dhe duke i shpjeguar personit të autorizuar për kryerjen e veprimeve simuluese që ka një kohë të gjatë që merret me shitjen e lëndës narkotike. Në përfundim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i arsyetuar dhe i marrë në përputhje me parashikimet ligjore të neneve 283 e 25 të KP-së, si dhe në çmuarje të drejtë të provave referuar nenit 152 të KPP-së.

5. Në datën 11.02.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27, pika 5, të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 17.03.2026.

II

Pretendimet e kërkuessit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se i është cenuar:

6.1. *E drejta e aksesit, e drejta e njoftimit, e drejta për t'u dëgjuar dhe e drejta për t'u mbrojtur*, pasi nuk i është komunikuar rekursi i bërë nga organi i akuzës ndaj vendimit të gjykatës së apelit, duke mos u njohur kështu me shkaqet e tij. Në këtë mënyrë, kërkuessi nuk ka pasur mundësi të paraqesë kundërrekurs, sipas nenit 435/a të KPP-së, për të kundërshtuar shkaqet që ka ngritur organi i akuzës. Po ashtu, kërkuessi nuk është njoftuar as për shqyrtimin e rekursit në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimit të nenit 436 të KPP-së. Këto shkelje kanë sjellë si pasojë zhvillimin e një procesi jo të rregullt, ku janë marrë në shqyrtim vetëm pretendimet e organit të akuzës.

6.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi kërkuessi është dënua sipas nenit 283, paragrafi i dytë, të KP-së mbi bazën e një prove të vetme, konkretisht përgjimit të datës 01.09.2020. Për kërkuessin nuk ka asnjë provë tjetër që të tregojë përfshirjen e tij në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283, paragrafi i dytë, i KP-së apo se ai ka bashkëpunuar me të pandehurin tjetër. Ai është dënua vetëm nga fjalët e nxjerra nga goja e tij, edhe pse ligji nuk dënon penalisht fjalët, qoftë edhe kur referojnë në veprime të paligjshme, nëse këto fjalë nuk janë të afta të kenë bazë të provueshme në prova që provojnë fajësinë në mënyrë të pakundërshtueshme. Sipas KPP-së, përgjimi është mjet për kerkimin e provës. Fajësia e kërkuessit për veprën penale për të cilën është akuzua nuk është provua te j çdo dyshimi të arsyeshëm. Kjo shkelje nuk është konstatua as nga Gjykata e Lartë.

6.3. *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi në seancën e datës 13.04.2021, ku janë paraqitura konkluzionet përfundimtare nga organi i akuzës, mbrojtësi i kërkuessit nuk ka qenë i pranishëm, për shkak se ka qenë në një seancë tjetër gjyqësore dhe për të mos shtyrë gjykimin është rënë dakord me trupin gjykues që në atë seancë të ishte i pranishëm vetë kërkuessi. Seanca e radhës është caktua në datën 27.04.2021 dhe i është lënë detyrë kërkuessit të njoftojë mbrojtësin. Në atë datë mbrojtësi ka paraqitura kërkesë se ndodhej në një çështje tjetër. Seanca është shtyrë për t'i lënë kohë mbrojtësit kryesisht të njëhej me aktet e dosjes. Në situatën që mbrojtësi i zgjedhur nuk është tërhequr nga përfaqësimi

dhe nuk e ka lënë mbrojtjen, largimi i tij pa asnjë shkak e bën procesin të parregullt.

- 6.4. *Parimi i gjyimit të drejtë*, pasi në seancën e datës 18.05.2021 nuk është bërë regjistrimi audio i seancës, duke u shkelur kështu detyrimet e KPP-së dhe rregullat e zhvillimit të procesit.
- 6.5. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e shkallës së parë dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk kanë respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë, për shkak të mungesës së një hetimi të plotë gjyqësor, çka ka sjellë mospërputhje të dukshme mes të dhënave të rezultuara nga hetimi dhe përfundimit të arritur nga gjykatat. Gjykatat kanë arritur në përfundimin e kryerjes nga kërkuesi të veprës penale të parashikuar nga neni 283, paragrafi i dytë, i KP-së pa pasur prova dhe pa analizuar vlerën provuese të secilës provë në lidhje me provat e tjera. Kolegji Penal nuk ka arsyetuar se cilat janë provat e tjera që janë analizuar nga gjykata e apelit. Gjykatat nuk kanë bërë arsyetim të detajuar për interpretimin dhe zbatimin e ligjit material penal, sipas nenit 283, paragrafi i dytë, të KP-së, në lidhje me rrethanat e faktit në ngarkim të kërkuesit.
- 6.6. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi referuar shkaqeve të rekursit, asnjë prej tyre nuk përfshihet në ato raste që hyjnë në kompetencë të Gjykatës së Lartë dhe që kanë të bëjnë me çështje të zbatimit dhe interpretimit të ligjit. Pra, shkaqet e rekursit nuk përfshihen në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së dhe Gjykata e Lartë në vlerësimin e tyre ka tejkaluar kompetencat e saj, në kundërshtim me funksionin e gjykatës së ligjit.
- 6.7. *Parimi i sigurisë juridike dhe ligjshmërisë*, për shkak të zbatimit nga Gjykata e Lartë të vendimit unifikues nr. 4/2021, pasi ka bërë një interpretim të gabuar të përfundimeve dhe gjetjeve të atij vendimi unifikues.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues

individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 10.04.2025, dhe i është njoftuar mbrojtësit të kërkuesit në datën 21.11.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 11.02.2026, pra brenda afatit 4-mujor.

9. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit, së drejtës së njoftimit, së drejtës për t’u dëgjuar, së drejtës për t’u mbrojtur, parimit të prezumimit të pafajësisë, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parimit për një gjykim të drejtë, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, si dhe parimit të sigurisë juridike dhe ligjshmërisë.

10. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të sigurisë juridike dhe ligjshmërisë*, kërkuesi ka argumentuar se Gjykata e Lartë ka zbatuar vendimin unifikues nr. 4/2021, duke bërë një interpretim të gabuar të përfundimeve dhe gjetjeve të atij vendimi unifikues.

11. Gjykata ka theksuar se interpretimi dhe zbatimi i ligjit, ku përfshihet edhe njësimi ose zhvillimi i tij me vendimin unifikues, është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit, Kolegji konstaton se, në thelb, ai ka të bëjë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes

konkrete, çka është një detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndaj, për rrjedhojë, ai nuk është ngritur në nivel kushtetues. Për më tepër, kërkuesi nuk ka sjellë asnjë argument sesi Gjykata e Lartë në çështjen e tij ka interpretuar gabim vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të saj. Në këtë kuptim, ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

13. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit për një gjykim të drejtë*, për shkak se në seancën e datës 18.05.2021 nuk është bërë regjistrimi audio i seancës, duke u shkelur kështu detyrimet e KPP-së dhe rregullat e zhvillimit të procesit, Kolegji vëren se ky pretendim i kërkuesit ka të bëjë me çështje të veprimtarisë së brendshme të gjykatës së shkallës së parë dhe me zbatimin e ligjit, duke mos u ngritur në nivel kushtetues, për sa kohë nuk është arritur të provohet në aspektin kushtetues cenimi i ardhur në të drejtat e tij kushtetuese nga veprimtaria e asaj gjykate. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi, sipas tij, shkaqet e rekursit të paraqitur nga organi i akuzës nuk përfshihen në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së dhe Gjykata e Lartë në vlerësimin e tyre ka tejkaluar kompetencat e saj, në kundërshtim me funksionin e gjykatës së ligjit. Edhe në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit, referuar thelbit të argumenteve të sjella në mbështetje të tij, Kolegji konstaton se ai ka të bëjë me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, duke mos e ngritur në nivel kushtetues dhe duke mos paraqitur asnjë argument kushtetues në mbështetje të tij. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim. Për më tepër, rezulton se Gjykata e Lartë e ka arsyetuar vendimmarrjen e saj në këtë drejtim dhe arsyetimi i saj nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që vijë në kundërshtim me konceptin e gjykimit të drejtë.

15. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, me argumentin se është dënuar mbi bazën e një prove të vetme, si dhe cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke argumentuar se gjykatat nuk kanë kryer një hetim të plotë nuk kanë analizuar vlerën provuese të secilës provë në lidhje me provat e tjera dhe nuk kanë arsyetuar për interpretimin dhe zbatimin e ligjit material penal sipas nenit 283, paragrafi i dytë, të KP-së. Nisur nga thelbi i këtyre pretendimeve, Kolegji vlerëson t'i analizojë ato të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

16. Për sa më lart, në vijim, Kolegji do t'i analizojë pretendimet e kërkuesit në drejtim të drejtës së aksesit, së drejtës së njoftimit, së drejtës për t'u dëgjuar dhe së drejtës për t'u mbrojtur të lidhura këto me njëra-tjetrën; parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me

standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor; si dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit, së drejtës së njoftimit, së drejtës për t'u dëgjuar dhe së drejtës për t'u mbrojtur

17. Lidhur me këto pretendime, Kolegji vëren se kërkuuesi i ka parashtruar ato në dy drejtime: i) mosnjoftimi i rekursit të paraqitur nga organi i akuzës, duke mos i krijuar mundësi për të paraqitur pretendimet e tij për çështjen; ii) mosnjoftimi i datës së seancës gjyqësore sipas parashikimeve të KPP-së.

18. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 26, datë 09.03.2026; nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 26, datë 09.03.2026; nr. 56, datë 10.10.2025; nr. 26, datë 09.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar se disa standarde kushtetuese janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, për situatat kur pretendohet mosnjoftimi i rekursit, Gjykata ka theksuar se njoftimi i akteve me të cilat vihet në lëvizje një proces gjyqësor ka rëndësi në drejtim të pjesëmarrjes së individit në gjykim dhe të realizimit të të drejtave të tij kushtetuese. Njoftimi i akteve gjyqësore në kohën e duhur përbën një garanci të domosdoshme si për të vënë në dijeni individin për procesin gjyqësor ku ai është palë, ashtu edhe për të garantuar pjesëmarrjen e tij në proces dhe ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes dhe përdorimin e mjeteve procedurale në funksion të mbrojtjes së tij, siç është kundërrekursi ose prapësimet ndaj pretendimeve të palës tjetër në proces (*shih vendimet nr. 26, datë 09.03.2026; nr. 41, datë 29.05.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato, ose të paraqesin argumentet e tyre për çështjen. Ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët

në proces kanë marrë dijeni efektivisht për procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimin e barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 26, datë 09.03.2026; nr. 32, datë 23.04.2024; nr. 16, datë 08.06.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke iu rikthyer rastit konkret, në lidhje me pretendimin për mosnjoftimin e rekursit, referuar materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, Kolegji konstaton se në datën 03.11.2021 rekursi i organit të akuzës i është komunikuar kërkuesit në adresën e mbrojtësit të zgjedhur prej tij, avokatit F.C. dhe është marrë në dorëzim nga avokatja S.J., e cila, po nga të njëjtat akte, nuk rezulton nëse ka qenë përfaqësuese e zgjedhur e kërkuesit. Në këtë drejtim, as vetë kërkuesi, i cili ka barrën e provës në procesin kushtetues, i cili është i natyrës argumentuese, nuk ka parashtuar në ankimin kushtetues asnjë argument për lidhjen e tij me avokaten S.J., e cila ka nënshkruar dëftesën e komunikimit të rekursit, ose cilësinë e saj në procesin gjyqësor ndaj tij. Po ashtu, rezulton se në datën 07.04.2025, tre ditë përpara zhvillimit të gjykimit në dhomën e këshillimit, kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësit të tij, avokatit F.C., ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë parashtimet dhe qëndrimet e tij për çështjen, duke kërkuar në fund lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Për rrjedhojë, Kolegji evidenton se kërkuesi ka marrë dijeni rregullisht për rekursin, i cili i është komunikuar atij në adresën e mbrojtësit të tij, avokatit F.C., dhe nuk është penguar për të parashtuar argumentet e tij pranë Gjykatës së Lartë në lidhje me çështjen e tij. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim janë haptazi të pabazuara.

21. Për sa i përket pretendimit tjetër se Gjykata e Lartë ka shkelur rregullat procedurale duke mos e njoftuar kërkuesin për zhvillimin e seancës sipas përcaktimeve të KPP-së, nga përmbajtja e dosjes gjyqësore rezulton se Gjykata e Lartë e ka realizuar njoftimin për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues, duke e afishuar si në këndin e njoftimeve në mjediset fizike, ashtu edhe në faqen elektronike të saj. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim janë haptazi të pabazuara.

22. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit, së drejtës së njoftimit, së drejtës për t'u dëgjuar dhe së drejtës për t'u mbrojtur, për shkak të mosnjoftimit të rekursit dhe të datës së seancës gjyqësore, janë haptazi të pabazuara.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkuesi ka argumentuar se fajësia e tij nuk është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm, pasi ai është dënuar mbi bazën e një prove të vetme, konkretisht përgjimit të datës 01.09.2020 dhe nuk ka asnjë provë tjetër që të tregojë përfshirjen e tij në kryerjen e veprës

penale. Po sipas kërkuessit, gjykatat nuk kanë kryer një hetim të plotë gjyqësor dhe këto shkelje nuk janë konstatuar as nga Gjykata e Lartë. Sipas kërkuessit, gjykata e shkallës së parë dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk kanë respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë, për shkak të mungesës së një hetimi të plotë gjyqësor, çka ka sjellë mospërputhje të dukshme mes të dhënave të rezultuara nga hetimi dhe përfundimit të arritur nga gjykatat. Ai ka argumentuar se gjykatat kanë arritur në përfundimin e kryerjes nga kërkuessi të veprës penale të parashikuar nga neni 283, paragrafi i dytë, i KP-së pa pasur prova dhe pa analizuar vlerën provuese të secilës provë në lidhje me provat e tjera. Kërkuessi ka argumentuar, gjithashtu, se Kolegji Penal nuk ka arsyetuar se cilat janë provat e tjera që janë analizuar nga gjykata e apelit dhe se nuk është bërë arsyetim i detajuar për interpretimin dhe zbatimin e ligjit material penal sipas nenit 283, paragrafi i dytë, i KP-së, në lidhje me rrethanat e faktit në ngarkim të tij.

24. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Sipas këtij parimi, asnjë dënim ose masë që barazohet me të nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 12, datë 24.08.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 1, datë 20.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se bashkëpunimi i kërkuesit në kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar rezulton e provuar nga procesverbali i transkriptimit të bisedës të datës 01.09.2020, i cili përputhet plotësisht me procesverbalin e sekuestrimit të provës materiale të lëndës narkotike të blerë (*shih paragrafin 2 të vendimit*). Ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit ka vlerësuar se përgjimi i transkriptuar, i cili është e vetmja provë në ngarkim të kërkuesit, e palidhur me asnjë provë ose indicie tjetër, e bën të pamjaftueshme bazueshmërinë e akuzës për të provuar fajësinë e kërkuesit për sa akuzohet (*shih paragrafin 3 të vendimit*). Ndërkohë, sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendimmarrja e gjykatës së apelit në lidhje me rrethanën cilësuese të bashkëpunimit dhe ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal të atribuar kërkuesit është e gabuar, pasi ajo nuk ka vlerësuar e çmuar provat e marra e të verifikuara në këtë gjykim, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 152 të KPP-së. Edhe sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë bashkëpunimi mes të gjykuarve është verifikuar nga përmbajtja e bisedave të përgjuara, të transkriptuara në aktet/procesverbalet e datës 01.09.2020, duke vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i arsyetuar dhe është marrë në përputhje me parashikimet ligjore të neneve 283 e 25 të KP-së, si dhe në çmuarje të drejtë të provave referuar nenit 152 të KPP-së (*shih paragrafin 4 të vendimit*).

27. Nga sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi kryesor i kërkuesit se është dënuar mbi bazën e një prove të vetme nuk qëndron, për sa kohë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (gjykata e shkallës së parë) e kanë mbështetur vendimin për fajësinë e tij jo vetëm në transkriptimin e bisedës të datës 01.09.2020, por edhe në procesverbalin e sekuestrimit të provës materiale, konkretisht lëndës narkotike të blerë, duke i vlerësuar ato në përputhje me njëra-tjetrën. Këto prova janë pasqyruar nga gjykata e shkallës së parë, mbi të cilat, më pas, ajo ka mbështetur vendimmarrjen e saj për fajësinë e kërkuesit për veprën penale të parashikuar neni 283, paragrafi i dytë, i KP-së. Edhe Gjykata e Lartë i ka kthyer përgjigje këtij pretendimi, duke arsyetuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në përputhje me parashikimet ligjore të neneve 283 e 25 të KP-së, si dhe në çmuarje të drejtë të provave referuar nenit 152 të KPP-së.

28. Po ashtu, referuar vendimeve të kundërshtuara nga kërkuesi, rezulton se gjykata e shkallës së parë e ka gjykuar kërkuesin me procedurën e gjykimit të shkurtuar, ku në zbatim të neneve 152 e vijues të KPP-së, pasi ka shqyrtuar provat e administruara, ka parashtruar në vendimin e saj, në mënyrë shteruese, mënyrën e vlerësimit të tyre dhe të indicieve që kanë rezultuar prej tyre, duke arsyetuar përfundimin e arritur në dispozitiv, si dhe duke u dhënë përgjigje pretendimeve kryesore të kërkuesit. Në këtë drejtim, edhe Gjykata e Lartë ka vënë në

dukje mosvlerësimin dhe mosçmuarjen nga ana e gjykatës së apelit të provave të marra e verifikuara në gjykim në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 152 të KPP-së, për sa i takon rrethanës cilësuese të bashkëpunimit dhe ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal të atribuar kërkuesit, duke evidentuar, gjithashtu, mospaqyrimin e saktë nga gjykata e apelit të mekanizmit të kryerjes së veprës penale dhe rolin e secilit prej të gjykuarve në raport me veprën penale.

29. Nisur nga sa më sipër, Kolegji evidenton se kërkuesi nuk ka arritur të tregojë se arsyetimi i gjykatave të zakonshme (gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykatës së Lartë), në drejtim të vlerësimit të provave dhe indicieve, është haptazi arbitrar, alogjik ose i pamjaftueshëm nga këndvështrimi kushtetues. Po ashtu, ai nuk ka arritur të tregojë se gjykatat kanë zhvendosur barrën e provës mbi të ose se përfundimi për fajësinë e tij për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283, paragrafi i dytë, i KP-së është mbështetur në pamundësinë për të rrëzuar akuzën. Përkundrazi, nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore rezulton se ky përfundim është mbështetur në vlerësimin e provave dhe indicieve të administruara në proces, sipas standardit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”.

30. Lidhur me argumentet e tjera të kërkuesit, të sjella në mbështetje të pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas të cilit nuk janë provuar elementet konstituive të veprës penale të parashikuar nga neni 283, paragrafi i dytë, i KP-së dhe se nuk është dhënë arsyetim i detajuar për interpretimin dhe zbatimin e ligjit material penal sipas kësaj dispozite, Kolegji evidenton se ato lidhen, në thelb, me vlerësimin e provave, indicieve dhe rrethanave faktike, si dhe me cilësimin juridik që gjykatat e zakonshme u kanë bërë veprimeve të kërkuesit, çështje të cilat nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues për sa kohë nuk rezultojnë haptazi arbitrar ose alogjike. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

31. Kërkuesi, në thelb, ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë ka caktuar mbrojtës kryesisht pa pasur më parë një tërheqje nga përfaqësimi i mbrojtësit të zgjedhur nga vetë kërkuesi dhe për këtë arsye është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

32. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se parimi i kontradiktoritetit në gjykim dhe ai i barazisë së armëve kërkojnë krijimin e mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose të përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe për deklaratimet e tyre për faktet, provat dhe

vlerësimet ligjore për çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në rastin konkret, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, rezulton se në seancën gjyqësore të datës 13.04.2021, të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë, kërkuesi ka deklaruar se do të vazhdonte gjykimin pa prezencën e avokatit të zgjedhur prej tij, shtetasit P.S. Kjo seancë gjyqësore është shtyrë për t'u zhvilluar në datën 27.04.2021 dhe njoftimin e avokatit P.S. e ka marrë përsipër vetë kërkuesi. Po ashtu, rezulton se në seancën e datës 27.04.2021, kërkuesi dhe avokati i tij P.S. nuk janë paraqitur në gjykim. Për këtë arsye, gjykata e shkallës së parë i ka caktuar kërkuesit mbrojtës kryesisht, duke vendosur edhe shtyrjen e gjykimit për një datë tjetër, për shkak të njohjes së mbrojtësit kryesisht me aktet e çështjes, në mënyrë që të paraqiste konkluzionet përfundimtare. Në seancën gjyqësore të datës 11.05.2021 është paraqitur mbrojtësi i zgjedhur nga kërkuesi, avokati P.S., dhe gjykata ka zëvendësuar mbrojtësin e caktuar kryesisht me avokatin P.S., duke vijuar kështu gjykimin në praninë e këtij të fundit, i cili ka realizuar mbrojtjen e kërkuesit deri në përfundim të procesit të atë gjykatë.

34. Në kuptim të sa më sipër, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Kolegji konstaton se atij i janë krijuar të njëjtat mundësi të barabarta me organin e akuzës për pjesëmarrjen në proces nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur prej tij, i cili pasi ka zëvendësuar mbrojtësin e zgjedhur kryesisht ka vijuar mbrojtjen, si dhe i janë krijuar të njëjtat mundësi të barabarta me organin e akuzës për deklaratimet e tij për faktet, provat dhe vlerësimin ligjor për çështjen. Për më tepër, Kolegji vëren se seanca e datës 27.04.2021, në të cilën, për shkak të mungesës së kërkuesit dhe mbrojtësit të zgjedhur, është caktuar një mbrojtës kryesisht, është shtyrë për t'i lënë kohë këtij të fundit për t'u njohur me aktet në funksion të përgatitjes së konkluzioneve, për rrjedhojë nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim procedural që lidhet me ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes në atë gjykim. Në këtë kuptim, Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka sjellë asnjë argument dhe nuk ka arritur të provojë sesi zëvendësimi i mbrojtësit të zgjedhur prej tij me mbrojtësin kryesisht në seancën gjyqësore të datës 27.04.2021 ose sesi mostërheqja nga përfaqësimi e avokatit P.S. ka cenuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

35. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.